



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

POSTA SHQIPTARE SH.A
DREJTORIA JURIDIKE

Tiranë, më 31.07.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje shirita plastik me numëror për thasët”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 39563520-7 (shirita transportues për tekstili)

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,000,000 (nëntë milion) Lekë, pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën 180,000 Lek (njëqind e tetëdhjetë mijë) .*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020; 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 39% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se **19%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit nenin 55, pika 4/b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

1. Operatori Ekonomik konkruues duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001 : 2015 ose ekuivalente, (Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

Certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizëm kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë. Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili nga operatorët duhet të disponoj certifikatë ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës objekt prokurimi në mënyrë

cilësore dhe të plotë, bazuar ne organizimin e brendshem për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi **ose** nga distributori i autorizuar nga *Prodhuesi (distributori duhet të vërtetojë se është autorizuar nga prodhuesi)*.

(Ky kriter vendoset për të vërtetuar që OE është i autorizuar nga prodhuesi për të prokuruar mallin objekt prokurimi, në respektim të mënyrave të parashikuara nga LPP, me qëllim që artikujt e kërkuar të jenë në përputhje me kërkesat teknike dhe cilësore të kërkuara).

Argumentim: Kërkesa për autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese, është kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë kapacitete teknike dhe profesionale të mjaftueshme dhe burimin e furnizimit pasi këto artikuj nuk janë artikuj që janë shumë të kërkuar dhe që mund të gjenden lehtësisht në treg.

2. Operatori ekonomike, duhet të paraqes test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO 527-2 për qëndrueshmërinë në tërheqje nga institucionet e certifikuara.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO 527-2, është kërkuar në bazë të pikës 1, të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet pajtuershmëria e produkteve me specifikimet teknike.

Theksojmë se: EN-ISO 527-2 është standart që përcakton kushtet e testimit dhe vetive të tërheqjes së materialeve plastike, bazuar në parimet e përgjithshme të dhëna në ISO 527-1.

Sqarojmë se kjo e fundit përcakton parimet e përgjithshme për përcaktimin e vetive elastike të materialeve plastike nën kushte të përcaktuara. Disa lloje të ndryshme të mostrave të testimit janë përcaktuar për t’iu përshtatur llojeve të ndryshme të materialeve.

3. Operatori ekonomike, në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesë mostra të mallrave që ofron, që duhet të përmbushin specifikimet teknike. Mos dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave, është kusht për skualifikim.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e test raport për shiritat plastik në përputhje me EN ISO 527-2, është kërkuar në bazë të pikës 1, të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri provohet fizikisht pajtuershmëria e produkteve me specifikimet teknike.

4. Operatori Ekonomik duhet të paraqes katalogun e prodhuesit/prodhuesve ku të përshkruhen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi në përputhje me ato të kërkuara nga AK.

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e katalogut të prodhuesit/prodhuesve ku të përshkruhen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, është kërkuar në bazë të pikës 1, të nenit të 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 , pika 6/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri provohen të dhënat teknike të produktit i cili ofrohet nga ofertuesi që vërteton pajtuershmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për **Shirita plastik me numrator për thasë, për mbulimin e nevojave të shërbimeve postare dhe financiare.**

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera e fondit limit të kontratës nga grupi i punës i ngarkuar për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është hartuar bazuar në mesataren e studimit të tregut, në mbështetje dhe zbatim të pikës 1, shkronja b) të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar ku parashikohet se: b) studimi i tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim. Praktikë e cila është e dokumentuar me dokumentacion shkresor në dosjen e prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT